

VENDIM
Nr. 777, datë 2.11.2016

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR E KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQEVE PYJORE QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “TAP-AG” PËR NDËRTIMIN E RRUGËVE TË KALIMIT DHE URAVE TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP), PAKETA E KATËRT, NË QARQET KORÇË DHE BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 6.059 (gjashtë pikë pesëdhjetë e nëntë) ha, që do të përdoret nga shoqëria “TAP-AG” për ndërtimin e rrugëve të kalimit dhe urave të gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), paketa e katërt, të hiqet nga fondi pyjor e kullësor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga regjistri i kadastrës së pyjeve dhe kullotave, sipas lidhjes 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që pakësohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor e kullësor publik sipas qarqeve e bashkive dhe hartave topografike me gjurmën e ndërtimit të rrugëve dhe urave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore dhe investimeve të kryera në vite në pyje, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria “TAP-AG”, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Shoqëria “TAP-AG”, brenda 2 (dy) viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, 8 (tetë) ha sipërfaqe me drurë pyjorë dhe të përmirësojë një sipërfaqe kullote prej 3 (tre) ha, në ekonomitë pyjore e kullësore të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë “TAP-AG” dhe Ministrisë së Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore e kullësore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme publike të bëjnë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore e kullësore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore dhe kullësore” dhe ta regjistrojnë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt ndërtimi i rrugëve dhe urave të gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”.

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bashkitë Korçë, Poliçan, Çorovodë e Berat dhe shoqëria “TAP-AG”, zyra për Shqipërinë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PUBLIK QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGEVE TE KALIMIT DHE
URAVE TE GAZSJELLESIT TAP, PAKETA E KATERT NË QARQET KORÇË DHE BERAT

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekonomia Pyjore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe preket nga gjurma (ha)</i>
KO21 00 025	EK Shere	25	ministra mjedisit	0.7692
KO52 00 014	EP Panarit Treske	14	ministra mjedisit	0.5123
KO52 00 013a	EP Panarit Treske	13a	ministra mjedisit	0.0501
KO52 00 012a	EP Panarit Treske	12a	ministra mjedisit	0.3482
KO52 00 009	EP Panarit Treske	9	ministra mjedisit	0.0413
KO64 00 026a	EP Sherre	26a	ministra mjedisit	0.0109
KO64 00 029d	EP Sherre	29d	ministra mjedisit	0.0004
KO64 00 031a	EP Sherre	31a	ministra mjedisit	0.1784
KO64 00 034a	EP Sherre	34a	ministra mjedisit	0.1067
KO64 00 035a	EP Sherre	35a	ministra mjedisit	0.1446
KO64 00 013b	EP Sherre	13b	ministra mjedisit	0.7308
KO64 00 012b	EP Sherre	12b	ministra mjedisit	0.3651
KO64 00 011b	EP Sherre	11b	ministra mjedisit	0.7883
KO66 01 064c	EP Vidhkuq Lubonje01	64c	ministra mjedisit	0.0357
KO66 01 064d	EP Vidhkuq Lubonje01	64d	ministra mjedisit	0.051
KO66 03 104	EP Vidhkuq Lubonje03	104	ministra mjedisit	0.3591
KO66 03 096a	EP Vidhkuq Lubonje03	96a	ministra mjedisit	0.0013
	Totali Korçë			4.4934
BR28 00 035b r1	EP Mali i Tërpanit	35b	njqv	0.0625
BR28 00 033b r1	EP Mali i Tërpanit	33b	njqv	0.3422
BR28 00 034c r1	EP Mali i Tërpanit	34c	njqv	0.4327
BR29 00 140a r1	EP Mali i Tomorrit	140a	njqv	0.3021
BR29 00 139a r1	EP Mali i Tomorrit	139a	njqv	0.2065
BR24 00 065 r1	EP Liqeth - Valë	65	njqv	0.2196
	Totali Berat			1.5656
GJITHSEJ	Korçë + Berat			6.059

Damian Gjokuri
MINISTËR

Lefter Koka
MINISTËR









